



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 05/11

Prishtinë, më 29.03.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Teki Shala, Ramadan Islami dhe Njomza Ilazi nga GIZ, si dhe monitorues nga Zyra e Presidentit, Zyra e USADI-it, OSCE dhe KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës. Rendi ditës miratohet pa ndryshime.

- 2. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011**

2.1. Shqyrtimi i kërkesës shtesë buxhetore të Zyrës së Presidentit të Kosovës

Kryetarja, kërkesa ka të bëjë për mjete shtesë për paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime.

Naser Osmani, theksoi se kërkesa e Zyrës së Presidentit për rritjen e pagave 25% të administratës së këtij institucioni, mbi pagat e administratës së Kuvendit nuk do të duhej të rezultojë me një vendim të Komisionit, që do të legjitimonte një çështje që nuk është e rregulluar me ligj. Si rezultat kërkesat shtesë të Presidentit nuk do të duhej të merreshin në konsideratë.

Muhamet Mustafa, theksoi nga buxheti shifet një rritje e buxhetit të Zyrës së Kryeministrit, ndërsa zvogëlim për Zyrën e Presidentit dhe Kuvendit. Mbështeti mendimin se nuk mund të ketë rritje të pagave për 25 % në bazë të analogjisë së pagës së Presidentit me bartësit tjerë të institucioneve publike, por se pozita e punëtorëve të administratave të këtyre tre institucioneve duhet të jetë e njëjtë. Zvogëlimi është i madhë mund të ketë problem në funksionimin e Zyrës së Presidentit.

Hykmete Bajrami, theksoi se kërkesa e stafit të Presidentit për barazimin me stafin e Kuvendit është e arsyeshme dhe duhet merret parasysh kjo kërkesë.

Naser Osmani, sa i përket pagave të administratës së Kuvendit, me Ligjin e Shërbyesve Civil është paraparë që pagat dhe kushtet e përgjithshme të administratës së Kuvendit, rregullohen me një vendim të Kryesisë së Kuvendit, për çka edhe kemi vendimin.

Bedri Hamza, theksoi se shërbyesit civil të Presidentit janë trajtuar njësojë sikurse shërbyesit civil në institucione tjera, përjashtimisht stafi i Kuvendit për shkak të një vendimi për shtesa që bazohet në ligj. Mjetet për Zyrën e Presidentit janë vlerësuar të mjaftueshme.

Xhevdet Neziraj, theksoi se për shkak të dallimeve në paga në mes stafit të Kuvendit dhe Presidentit, dhe duke pasur parasysh faktin dy administratat janë me një ndërtesë të njëjtë dhe punë e njëjtë, dhe duke ditur se nuk do të shkaktonte implikime të mëdha buxhetore, do të ishte mirë që të merret parasysh kërkesa e Zyrës së Presidentit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me nëntë vota Për, dy Kundër (Sali Asllanaj dhe Xhevdet Neziraj) dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Nuk përkrahen kërkesat buxhetore shtesë të Zyrës së Presidentit.

2.2. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore shtesë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë

Muhamet Mustafa, veçoi rëndësinë e kërkesave që kanë të bëjnë me blerjen e standarteve janë të rëndësishme, nga të cilat varet certifikimi i cilësisë së prodhuesve kosovar për të plotësuar standartet evropiane, duhet të jemi shumë të kujdesshëm në trajtimin e këtyre kërkesave.

Hykmete Bajrami, theksoi se blerja e standarteve, laboratorit dhe implementimi i aktiviteteve të CEFTA-së, janë shumë të rëndësishme, që meritojnë trajtimin serioz të tyre. Edhe pse kjo ministri ka mbështetje nga donatorët, ata kushtëzojnë një participim nga buxheti i Kosovës. Kemi të bëjmë me ndarjen e mjeteve për investim dhe jo vetëm shpenzim.

Bedri Hamza, kërkesa buxhetore të kësaj organizata buxhetore janë trajtuar me rastin e organizimit të dëgjimeve buxhetore dhe buxheti si ti tillë është aprovuar në Qeveri. Mundësia është që të bëhen riedestinime të brendshme brenda buxhetit të Ministrisë.

Sali Asllanaj, duke vlerësuar kërkesat shumë të rëndësishme, theksoi është dashur që Ministresha para aprovimit të buxhetit në Qeveri, ti ngri këto çështje. Përndryshe është vështirë të plotësohen këto shuma të mëdha, në kompenzim të marrjes së mjeteve ndonjë organizate tjetër. Do të ishte mirë të gjindeshin burime tjera alternative të financimit të këtyre kërkesave.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Nuk përkrahen kërkesat buxhetore shtesë të Ministrisë së Tregtisë dhe Financave.

2.3. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore shtesë të Ministrisë së Infrastrukturës

Naser Osmani, njoftoi se kemi të bëjmë me ridestitim të mjeteve të projekteve kapitale brenda ministrisë së caktuar.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahen kërkesa buxhetore e Ministrisë së Infrastrukturës, për ridestitime të brendshme të projekteve kapitale brenda buxhetit të kësaj Ministrie.

2.3. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore shtesë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Bedri Hamza, pasi që kemi të bëjmë me projektet për punësim të qëndrueshëm për tri ministritë e linjës e që financohen nga Banka Qendrore, si Ministri e Financave propozojë që të shtohet një vijë e veçantë buxhetore për shfrytëzimin e këtyre mjeteve, ku do të propozohet edhe teksti, në një nen të veçantë. Do të jene rregullime të brendshme.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahet kërkesa buxhetore për rregullime të brendshme brenda Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në emër të projektit për punësi të qëndrueshëm, që do të financohen nga Banka Botërore.

2.4. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë së Administratës Publike

Kryetarja, kërkesa ka të bëjë me shpërndarjen e mjeteve për institucionet që nuk janë në objektin e Qeverisë, të mirëmbajnë vet ndërtesën e tyre.

Bedri Hamza, theksoi se kërkesa është vonuar dhe si e tillë ndryshon strukturën e tabelave buxhetore, dhe krijon probleme teknike, që duhet bërë ndryshime për shumë organizata për shkak të ndryshimit të buxhetit të tyre.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Nuk përkrahet kërkesa buxhetore e Ministrisë së Administratës Publike për bartjen e mjeteve në organizatat buxhetore në emër të mirëmbajtës së objekteve.

2.5. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë për rregullim të brendshëm të projekteve kapitale

Bedri Hamza, pasi kemi të bëjmë me rregullim të brendshëm, për ministrinë është e pranueshme kjo kërkesë.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahet kërkesa buxhetore e Ministrisë së Shëndetësisë për rregullim të brendshëm të projekteve kapitale.

2.6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Komunës së Suharekës

Kryetarja, prezantoi kërkesat e Komunës, e cila ishte e pasqyruara edhe me shkrim.

Sali Asllanaj, kërkoi që për projektin i cili është planifikuar të realizohet me bashkëfinancim, më përkrahen e donatorëve e që është përkrahur edhe nga ministri i linjës, të ndahen mjetet që nuk konsiderohen se janë të një kostoje të mëdha.

Bedri Hamza, vlesëri arsyeshmërin e projektit me bashkëfinancim, dhe theksoi se sipas vendimit të Komisionit, Ministria do të gjejë mjetet në emër të shkurtimeve buxhetore.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahet kërkesa buxhetore e Komunës së Suharekës për realizimin e projektit me bashkëfinancim.

2.7. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Komunës së Shtërpcës

Kryetarja, shpjegoi se kërkesa ka të bëjë me punëtor shtesë që kanë dalur si rezultat i bartjes së kompetencave nga agjencioni i pyjeve, nëpër komuna.

Jelena Bontic, theksoi se kërkesa e komunës në fjalë ka të bëjë me ndarjen e mjeteve për dy deputetë, si dhe tri pozita të reja, si dhe pesë rritje të koeficienteve.

Naser Osmani, përkrahu kërkesat për rritjen e punëtorëve dhe shtesat për këshilltarët, po jo edhe rritjen e koeficinetëve.

Bedri Hamza, propozojë që kërkesa për 16 punëtor të realizohet për dy vite, këtë vit të lejohen tetë punëtor dhe pagat për këta punëtor, vitin tjetër tetë të tjerët.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahet kërkesa buxhetore e Komunës së Shtërpçës, për shtimin tre punëtorëve, dhe pagat për këta punëtor dhe dy këshilltar. Ndërsa nuk kërkesa për rritje të koeficienteve nuk u përkrah.

2.8. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Komunës së Pejës

Kryetarja, njoftoi se kërkesa e komunës në fjalë për zvogëlimin e numrit të punëtorëve dhe mjetet nga pagat dhe mëditjet të transferohen në mallra dhe shërbime.

Hykmete Bajrami, theksoi se kemi të bëjmë me një kërkesë interesante, që thënë ndryshe do të largohet dikush prej pune ndërsa do të rriten privilegjet siq kërkohet të barten në mallra dhe shërbime, do të ishte e justifikueshme sikurse të kërkohej të transferoheshin mjetet në investime kapitale. Nëse kanë punëtorë shtesë, le t'iu shkurtohet buxheti në emër të zvogëlimit të numrit të punëtorëve.

Bedri Hamza, kërkesa mund të ketë arsyeshmërinë, që në emër të zvogëlimit të punëtorëve, disa shërbime të jepen në formë të kontraktuar, përmes pagesës nga mallrat dhe shërbimet. Përkrahim këtë kërkesë dhe është nën autonominë e Komunës, si e bënë rregullimin e brendshëm.

Xhevdet Neziraj, theksoi se është fakt ajo çka thotë Ministri, rasti i shërbimeve të sigurimit, Komuna në formë të kontraktuar ia ka dhënë shërbimin një kompanie private të sigurimit.

Hasime Krasniqi, mbështeti kërkesën e Komunës përkatëse, por njëkohësisht kërkojë që punëtorët që largohen nga buxheti i komunës dhe kalojnë në punët kontraktuale, të kushtëzohen kompanitë kontraktuese, që të mbajnë këta punëtor në punë.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahet kërkesa buxhetore e Komunës së Pejës për zvogëlimin e numrit të punëtorëve dhe bartjen e mjeteve në emër të këtyre punëtorëve, në kategorinë mallra dhe shërbime.

2.9. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Agjencisë Kosovare të Intelgjencës

Bedri Hamza, duke vlerësuar rëndësinë e këtij agjencioni dhe nevojën për funksionalizimin e saj, kur dihet se është në konsolidim e sipër, kërkoi që kërkesa e tyre të përkrahet edhe nga Komisioni.

Albana Fetoshi, përkrahu kërkesat e Agjencisë Kosovare të Intelgjencës.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahet kërkesa buxhetore e Agjencisë Kosovare të Intelgjencës.

2.9. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Asociacionit të Komunave të Kosovës

Kryetarja, njoftoi se kërkesa ka të bëjë me rritje të pagave të këshilltarëve, ne nuk rrisim pagat, kjo çështje do të rregullohet me ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Nuk përkrahet kërkesa buxhetore e Asociacionit të Komunave të Kosovës

2.10. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Komunës së Parteshit

Bedri Hamza, sugjeroi që kërkesa e kësaj Komuna të bëhet në Ministrinë e Financave dhe nëse ka nevojë për mjete buxhetore, konform ligjit dhe me vendim të Qeverisë, do të plotësohet kërkesa nga rezerva e Qeverisë.

Albana Fetoshi, theksoi se këto komuna janë krijuar si rezultat i procesit të decentralizimit dhe ato kanë mjaftë buxhet.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komuna e Parteshit të paraqes kërkesën në Ministrinë e Financave. Qeveria në bazë të Ligjit të shqyrtojë kërkesën dhe me vendim të lejojë bartjen e mjeteve buxhetore nga rezerva e Qeverisë.

2.11. Shqyrtimi i buxhetit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2011

Naser Osmani, propozoi që buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës të kalojë në kuadër të buxhetit të Kuvendit. Mjetet buxhetore RTK, do të mund ti shfrytëzojë pas dërgimit të planit të detalizuar të shpenzimeve në Kuvend.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahet kërkesa që buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës të kalojë në kuadër të buxhetit të Kuvendit.

2.10. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Kosovës

Ismet Krasniq, thekoi se pas rishqyrtimit të kërkesës, është vlerësuar se mund të bëhen disa shkurtime buxhetore dhe atë si rezultat i mungesës së seancave dhe aktiviteteve të komisioneve në tre muajt e këtij viti, mjetet nga pagat për tre muajt që po kalojnë në emër të 16 punëtorëve të planifikuar, zbritja nga mallrat dhe shërbimeve në emër të hapjes e zyrave rajonale dhe kërkesa në total pas zbritjeve është 220.000€

Naser Osmani, mbështet kërkesat e Kuvendit. Në kërkesën e Kuvendit është një lëshim në tabelën 3.2, ku ka të bëjë me automjetet për deputetët, që duhet të jetë për nevoja të Kuvendit

Bedri Hamza, mbështesim kërkesën e zvogëluar të Kuvendit dhe theksoi se jemi për të mbështetur funksionalizimin e punës së Kuvendit.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahet kërkesa buxhetore e Kuvendit të Kosovës.

2.11. Shqyrtim i nenit 4 të pjesë tekstuale të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011

Bedri Hamza, në emër të Qeverisë, propozoi që neni 4 të riformulohet si në vijim: “Vendimi i Qeverisë nr.02/03 i dt. 9 mars 2011, për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës Sh.A. i cili i është bashkangjitur këtij Ligji si Aneks, konsiderohet i miratuar nga Kuvendi nga data e hyrjes së fuqi të këtij ligji. Ky miratim e plotëson kërkesën për miratim nga Kuvendi të përcaktuar me nenin 9.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.”

Naser Osmani, theksoi se çështja e privatizimit të Postës nuk është dashur të jetë fare pjesë e projektligjit të buxhetit. Strategjia për privatizimin e postës ka qenë në Kuvend dhe tani kemi një propozim vendim të Qeverisë që duhet të trajtohet në Kuvend dhe ky është një proces i ndarë prej buxhetit. Propozoi që neni 4 të fshihet tërësi.

Albana Fetoshi, neni 4 duhet fshirë në tërësi, nuk duhet lejuar të kontrabandohet Posta duke shkelur Kushtetutën dhe ligjet.

Muhamet Mustafa, çështja e privatizimit është e lidhur me buxhetin, por mënyra si po pretendon Qeveria me lidh me buxhetin nuk është mënyra më e mirë. Privatizimi i Postës duhet të trajtohet si çështje e veçantë në seancë. Ndërkaq mund të rregullohet me ligj, mundësia e përdorimit të fondeve nga shitja e ndërmarrjeve publike, e të cilat do të mund të përdorëshin vetëm për shpenzime kapitale.

Sali Asllanaj, theksoi se mbështet privatizimin e postës dhe është dashur të privatizohet kur asetet kanë qenë më të mëdha. Ndërkaq sa i përket mënyrës së privatizimit kërkojë që të fshihet neni 4 dhe kjo çështje të diskutohet në mënyrë të veçantë në seancë plenare.

Bedri Hamza, vlerësoi se nuk ka rëndësi a mbetet në këtë formë apo si vendim i veçantë, dhe kjo nuk përjashton kërkesën për transparencë të privatizimit të postës.

Hykmete Bajrami, mbështeti propozimin që neni 4 të fshihet. Nëse e lëmë nenin katër nuk po reflektohen kërkesat e deputetëve për transparencë për formën dhe mënyrën e privatizimit të postës. Për këtë çështje duhet të ketë seancë të veçantë.

Duda Balje, theksoi se nuk e shohë rrezik që të mbetet ky nen, dhe kjo nuk do ta zvogëlojë kualitetin e privatizimit të postës.

Safete Hadërgjonaj, mbetja e nenit 4 nuk është kundërkushtetuese dhe kundërligjore dhe mbështeti propozimin e Qeverisë.

Për propozimin e Qeverisë për riformulimin e nenit 4, pesë anëtarë votuan Për (Safete Hadërgjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Jelena Bontic dhe Duda Balje), Pesë Kundër (Naser Osmani, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi dhe Muhamet Mustafa) dhe Një Abstenim (Xhevdet Neziraj)

Për propozimin e Deputetit Naser Osmani që të fshihet neni 4, pesë anëtarë votuan Për (Naser Osmani, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi dhe Muhamet Mustafa), Pesë Kundër (Safete Hadërgjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Jelena Bontic dhe Duda Balje), dhe Një Abstenim (Xhevdet Neziraj)

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni vendosi që për neni 4 të Projektligjit për Buxhetin 2011, në raportin me amendamente drejtuar Kuvendit për miratim të dal me dy propozimet e lartpërmendura.

Agim Krasniqi, propozoi shtimin e një neni që rregullon çështjen e shfrytëzimit të mjeteve në emër të projekteve për punësim të qëndrueshëm, me financim nga Banka Botërore. Ne do të damë mjetet, ndërsa kur ti sjell BB, Ministri ka të drejtë ti marrë këto mjete.

Në vazhdim u përkrahen edhe riformulimi i nenit 12.2 dhe 17, dhe shtimi i nenit të ri sipas propozimit të Qeverisë.

Komisioni autorizojë Ministrinë e Financave, që të propozojë shkurtimet buxhetore, për mbulimin të kërkesave buxhetore shtesë të përkrahura nga Komisioni. Propozimi do të prezantohet në formë të amendamentit në raportin e Komisionit drejtuar Kuvendit për Buxhetin 2011.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ